

VENDIM
Nr. 638, datë 29.7.2020

PËR TRAJTIMIN ME USHQIM PA PAGESË TË PUNONJËSVE DHE
KURSANTËVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Trajtimin me ushqim pa pagesë të punonjësve, oficerë, nënoficerë dhe kursantë, të Gardës së Republikës.

2. Trajtimi, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet:

a) me një vakt (drekë), të gjithë punonjësit oficerë e nënoficerë dhe kursantët kur kohëzgjatja e punës së punonjësve dhe përgatitjes së kursantëve është 8 (tetë) orë;

b) me tri vakte, kur punonjësit janë të angazhuar në shërbime, gatishmëri apo trajnime dhe kohëzgjatja e shërbimit, e gatishmërisë apo e trajnimit të kursantëve dhe e personelit trajnues zgjat 24 (njëzet e katër) orë.

3. Trajtimi bëhet me ushqim të gatuar, në mensa dhe me shërbim shpërndarjeje (*catering*), i cili u nënshtrohet të gjitha procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Normat e ushqimit ditor të k/kalorive, për të gjitha strukturat e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Brendshëm, ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku përcaktohen:

a) normat e artikujve ushqimorë, brenda limitit të miratuar të k/kalorive, duke ruajtur raportin e njësive ushqimore;

b) normat e zëvendësimit të artikujve ushqimorë;

c) normat e pajisjeve dhe të materialeve të shërbimit të ushqimit.

5. Për rastet kur kategoritë përfituese, sipas këtij vendimi, për shkak të detyrës janë larg qendrës së punës e të shërbimit dhe kur shërbimi i shpërndarjes (*catering*) nuk mund të realizojë furnizimin me ushqim në terren, bëhet kompensimi në vlerë (në lekë), për ditët efektive të punës. Vlera e kompensimit (në lekë) të ushqimit bëhet bazuar në normën e përcaktuar ushqimore dhe miratohet nga Komandanti i Gardës.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Brendshme, në programin buxhetor “Garda e Republikës”.

7. Vendimi nr. 702, datë 21.8.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Gardës së Republikës, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe kursantëve në shkolla të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar deri në sqarimin e pozitës së tyre”, shfuqizohet.

8. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe